

Akreditim i programeve të studimit
Universiteti i Prizrenit
Raporti Final

Aplikacioni për akreditim

- ✓ Administrim Biznesi (BA) dhe Menaxhment Ndërkombëtar (BA)
- ✓ Menaxhment në Agrobiznes (MA)
- ✓ E drejta Ndërkombëtare dhe Integritime Evropiane (MA)

1. Pjesëmarrësit:

1.1. Ekipi i Ekspertëve (EE):

- ✓ Prof. Dr. Jochen Kantelhardt / Universiteti i burimeve natyrore dhe Shekncave të Jetës(Austri)
- ✓ Prof. Dr. Frédéric Mertens de Wilmars / Universiteti i Valencisë (Spanjë)
- ✓ Prof. Dr. Hans Tümmers / (ish) Universiteti I Hohenheim në Stuttgart (Gjermani)

1.2. Koordinatorët e AKAsë:

- ✓ Prof. Dr. Ferdije Zhushi-Etemi (Këshilli Shtetror i Cilësisë /AKA)
- ✓ Znj. Furtuna Mehmeti (Eksperte për Vlerësim dhe Akreditim/AKA)
- ✓ Z. Fisnik Gashi (Zyrtar për vlerësim dhe monitorim /AKA)

2. Riakreditim programi

EE-ja ishte thirrur për të vlerësuar ri-akreditimin e tre programeve akademike, një në nivelin bachelor dhe dy programe tjera në nivelin master: Administrim Biznesi (BA); Menaxhment në Agrobiznes (MA) dhe Te drejtë Ndërkombëtare dhe Integritime Evropiane (MA).

Procesi i riakreditimit u mbështet në:

- ✓ Raporti i Vetëvlerësimit i Universitetit të Prizrenit (RVV) datë 2014/2015
- ✓ Vizita në terren në objektet e Universitetit të Prizrenit (më 28 -29 maj 2015) dhe diskutimet me: menaxhmentin e universitetit, personat përgjegjës për programet e studimit, personelin mësimdhënës dhe 8 studentë.
- ✓ Dokumentet shtesë të kërkuara nga EE-ja pas vizitës në terren.

3. Dokumentet e pranuar para dhe pas vizitës në terren

Dokumentet e pranuar janë:

- ✓ Raporti i vetëvlerësimit (RVV): Ndërsa disa prej mospërputhjeve dhe gabimeve në lidhje me disa të dhëna ishin korrigjuar në RVV-në e kaluar, ka akoma gabime të tjera në përkthimin anglisht (akoma në version e përkthyer ne anglisht ka fraza në gjuhën shqipe, si p.sh. në CV-të e stafit akademik) dhe përshkrime të vagullta të disa programeve akademike. Për këtë arsye, takimet me stafin gjatë vizitës në terren sqaruan disa aspekte dhe EE-ja falënderon menaxhmentin e lartë dhe personat përgjegjës për secilin program akademik.
- ✓ Programi i vizitës në terren i datës 28-29 maj 2015
- ✓ Udhëzuesi i AKA-së për ekspertët (programet akademike dhe institucioni), Kodi I praktikës së mire për vizitat në terren dhe Standardet.
- ✓ Tre raportet e vlerësimit për akreditim të programeve: 31 mars–1 prill 2014; 13-14 maj 2013; 1 qershor 2012 dhe 2 korrik 2011.
- ✓ 20 CV-të e stafit akademik në Agrobiznes; 11 CV-të e stafit të programit Administrim Biznesi dhe Menaxhment Ndërkombëtar; dhe 4 CV-të e stafit akademik në programin E drejta ndërkombëtare dhe integritime evropiane (të gjitha të pranuar në formë elektronike nga AKA-ja më datë 1 qershor 2015)

- ✓ Komentet e Universitetit të Prizrenit rreth raportit të përkohshëm të EE-së: *Komentet janë bërë bazuar në REE-në e AKA-së. Menaxhmenti dhe stafi akademik përgjegjës për programet e studimit kanë punuar në këtë dokument. Të gjithë akademikët (profesorët) kanë punuar në mënyrë individuale dhe si rezultat mund të këtë dallime të shpërfillshme në mënyrën e përgjigjeve ndaj komenteve”.*

4. Vëzhgime për secilin program studimi

4.1. Administrim Biznesi (BA) dhe Menaxhim Ndërkombëtar (BA) (Prof. Dr. Hans Tümmers)

4.1.1. Vëzhgime të përgjithshme të nxjerra nga takimet dhe vizita

Parimi udhëheqës reflekton një strategji shumë ambicioze për programet me synimin “për të krijuar dhe mbarë vajtur standardet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, hulumtimit dhe kreativitetit artistik”. Kjo strategji dukshëm ka nevojë për mjete të mëdha financiare që nuk do të jenë të mundshme në të ardhmen e afërt. Rrjedhimisht, një filozofi mësimdhënieje më e orientuar kah aplikimi, bazuar në bashkëpunimin me industrinë dhe administratën, do të ishte më e përshtatshme për universitetin.

Një program hulumtimi ambicioz do të kishte nevojë për një strukturë tjetër administrative me më shumë profesorë, asistentë dhe studentë të doktoratës.

Megjithatë, duke qenë se programet kanë filluar vetëm pak vite më parë, ata janë ende në fazë eksperimentale dhe jo të gjitha qëllimet mund të arrihen brenda kësaj periudhe të shkurtër. Megjithatë, duket se ka përfshirje të fortë dhe entuziazëm për t’i bërë të suksesshëm të dy programet.

4.1.2. Programet akademike

Dy programet Bachelor në Administrim Biznesi DHE NË Menaxhment Ndërkombëtar në Universitetin e Prizrenit kanë filluar në vitin 2011; një vit pasi universiteti u themelua. Strukturat e tyre korrespondojnë me gradën tipike të Bachelor-it tre vjeçar sipas sistemit të Bolonjës, duke përfshirë një total prej 180 ECTS për secilin.

Programi Bachelor në Administrim Biznesi jepet në dy përqendrime: një në Kontabilitet dhe një në Menaxhimin e Biznesit Bujqësor. Kjo reflekton nevojat e ekonomisë kosovare: financa

dhe kontabiliteti janë tema themelore për çdo biznes dhe në pikëpamjen e rëndësisë së sektorit bujqësor, përqendrimi në këtë fushë me gjasë krijon perspektiva premtuese për të diplomuarit.

Koherenca e silabusit të të dy programeve është diskutuar gjatë vlerësimeve të fundit dhe nuk do të diskutohet sërish këtu. Megjithatë, disa komente do të ishin të përshtatshme:

Rekomandime:

- ✓ Regjistrimi i 4400 studentëve për secilin program nuk është i menaxhueshëm nën kushtet aktuale, konkretisht mungesa e stafit mësimor të mjaftueshëm, qasja në kompjuter, biblioteka, klasat, praktikat etj.. Edhe 200 studentë për program do të ishte një shifër ambicioze. Fakti që niveli i braktisjes së studimeve pas vitit të parë është 40% tregon se menaxhimi i studentëve nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu, është jo realiste të gjenden 400 praktika të përshtatshme për vit në ekonominë kosovare.
- ✓ Në të dy programet, trajnimi i gjuhës, veçanërisht në anglisht, duhet të zgjerohet. Në takimin me studentët, niveli i anglishtes ishte dukshëm i ulët.
- ✓ Një gjuhë e huaj e dytë (tjetër nga turqishtja) duhet të jetë e detyrueshme që nga fillimi. Sot, biznesi është ndërkombëtar dhe pa pasur aftësi gjuhësore të mjaftueshme, mundësia e punësimit për të diplomuarit është shumë e kufizuar. Studentët janë ambiciozë dhe të vendosur për të pasur sukses dhe rrjedhimisht kanë nevojë për aftësi të përshtatshme për punë.

4.1.3. Fakulteti dhe zhvillimi i fakultetit

Lista e profesorëve dhe stafit nuk ishin shumë të qarta. Kësisoj, nuk është e kuptueshme se sa profesorë me kohë të plotë, respektivisht profesorë të asociuar ose asistentë ka në Universitetin e Prizrenit, cilët janë profesorët me kohë të pjesshme që vijnë nga universitete të tjera dhe cilët vijnë nga industria. Megjithatë, CV-të dhe diskutimet personale me stafin dhanë përshtypjen se fakulteti është mjaftueshëm i kualifikuar për të dhënë mësim në programet në fjalë.

Rekomandime:

- ✓ Për rekrutimin e mëtejshëm të profesorëve, do të ishte shumë e vlefshme të konsideroheshin kualifikimet gjuhësore. Veçanërisht profesorët e administrim biznesit duhet të jenë të aftë të komunikojnë në anglisht. Ishte zhgënjyese që përkthimet qenë të domosdoshme gjatë bisedave.

- ✓ Shumica e literaturës shkencore është në anglisht dhe çdo bashkëpunim ndërkombëtar është thjesht i pamundur pa përdorimin e anglishtes. Rekomandohet gjithashtu punësimi i profesorëve të rinj me sfond ndërkombëtar dhe ftesa e më shumë lektorëve nga jashtë.

4.1.4. Hulumtimi

Mësimdhënia në universitet bazohet mbi hulumtimin, si hulumtimi personal i profesorëve, ashtu edhe hulumtimi i komunitetit shkencor, i paraqitur në konferenca dhe i botuar në libra dhe revista. Nga CV-të del se disa nga profesorët janë të përfshirë në projekte hulumtimi dhe i botojnë rezultatet e tyre. Megjithatë, në shumicën e rasteve, këto aktivitete janë individuale, nuk janë pjesë e projekteve ndërkombëtare të universitetit dhe të paraqitura në konferenca ndërkombëtare.

Siç u tha në pikën 5.1.1, një program hulumtimi ambicioz do të kishte nevojë për një strukturë tjetër administrative me më shumë profesorë, asistentë dhe studentë të doktoratës. Për sa kohë që mjetet e nevojshme nuk janë të mundshme, duhet të konsiderohen mundësi të tjera.

Rekomandim:

- ✓ Në mënyrë që të stimulohen aktivitetet e hulumtimit, rekomandohet krijimi i një instituti kërkimor në Administrim Biznesi në Departamentin e Ekonomisë, për të shkruar dhe për të stimuluar të gjithë aktivitetet hulumtuese individuale. Duke e bërë këtë, fakulteti mund të përmirësojë perceptimin publik si qendër e hulumtimit dhe të marrë pjesë s universitet në projektet ndërkombëtare të hulumtimit.

4.1.5. Infrastruktura dhe Pajisjet

Gjendja e fakultetit lidhur me bibliotekën dhe pajisjet elektronike që kanë qasje në burimet dhe dokumentet shkencore botërore janë ende tepër të pamjaftueshme dhe kanë nevojë për përmirësim. Për momentin, nuk ka revista shkencore dhe numri i librave shkencorë (në anglisht) është shumë i kufizuar.

Përveç kësaj, pajisjet e klasave janë të mjaftueshme dhe i përgjigjen kriterëve për mësimdhënie efektive.

Rekomandim:

- ✓ Universiteti duhet të përmirësojë bibliotekën dhe të garantojë qasje në databazën ndërkombëtare. Financimi i mëtejshëm duhet të ngrihet në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar (Komisioni i BE-së, Tempus dhe programe të tjera).

4.1.6. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Kjo është me gjasë një nga pikat më kritike në zhvillimin e të dy programeve. Të studiosh biznes – dhe akoma më shumë menaxhim ndërkombëtar! – në një mjedis të vetëm kombëtar apo edhe lokal është tërësisht jashtë mode sot. Siç është përmendur më parë, ndërkombëtarizimi i programeve kërkon, para së gjithash, aftësi të mira gjuhësore në anglisht, si nga profesorët, ashtu edhe nga studentët. Ai kërkon gjithashtu mundësinë e studimit jashtë dhe ftesën e profesorëve nga vende të tjera.

Për momentin, Raporti i Vetëvlerësimit përmend bashkëpunimin me 14 universitete të huaja, ndër të cilat 4 në Turqi, 4 në vende të tjera të ish Jugosllavisë, 3 në Gjermani dhe një në SHBA (shih faqen 432 të raportit). Këto marrëdhënie lidhen kryesisht me aktivitetet e hulumtimit dhe prodhojnë vetëm efekte minore për studentët.

Është e dukshme se programet tradicionale të shkëmbimit bazuar në modelin ERASMUS mund të luajnë vetëm një rol të kufizuar, duke qenë se vetëm pak studentë nga jashtë Kosovës do të zgjidhnin të studionin në Prizren. Rrjedhimisht, duhet të konsiderohen mundësi të tjera.

Rekomandime:

- ✓ Fakulteti duhet të ndjekë objektivin për të gjetur universitete në vendet e OECD-së si sponsorë. Për këto sponsorizime, financimi është i mundur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (Bashkimi Europian, kompanitë ndërkombëtare).
- ✓ Kjo do të përfshinte mundësinë që studentët të studiojnë një semestër jashtë dhe që profesorë të huaj të ftohen në Prizren. Rrjedhimisht, fakulteti duhet të krijojë një zyrë ndërkombëtare dhe të studiojë të gjitha mundësitë për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

4.1.7. Komente nga Universiteti i Prizrenit

1. Programi Administrim Biznesi (AB): Lënda “Biznesi dhe tregtia elektronike” duhet të zëvendësohet me lëndën “Sipërmarrje” – semestri i parë, viti i parë

2. Programi Menaxhment Ndërkombëtar (MN): Lënda “ Biznesi dhe tregtia elektronike” duhet zëvendësuar me lenden “Sipërmarrje”, semestri katër, viti i dytë.

4.1.8. Përfundime rreth ri-akreditimit të Administrim Biznesit (BA) dhe Menaxhment ndërkombëtar (BA)

Fakulteti i Ekonomisë është ende në një fazë të hershme të zhvillimit të tij dhe të dy programet e vlerësuara kanë filluar vetëm katër vite më parë. Programet mësimore korrespondojnë me standardet ndërkombëtare. Me numrin e lartë të studentëve, ato duken të suksesshme. Arritjet e viteve të fundit janë mjaft mbresëlënëse.

Raporti i Vetëvlerësimit, diskutimet me stafin dhe vizita në terren në 28 dhe 29 maj justifikojnë ri-akreditimin e të dy programeve për një periudhë tjetër tre vjeçare, Megjithatë, kushtet e përgjithshme (biblioteka, kompjuterët, marrëdhëniet ndërkombëtare, trajnimi i gjuhëve) duhet të përmirësohen dhe siç u përmend në këtë raport, duhet të ndërmerren nj sërë masash në mënyrë që të justifikohet përfundimisht cilësia e tyre si programe universitare.

4.2. E Drejta Ndërkombëtare dhe Integrimi European (LL.M.) (Prof. Frédéric Mertens de Wilmars)

4.2.1. Gjetje të përgjithshme

Profesori Mertens u takua me Dekanin e Fakultetit të Juridikut, Prof. Dr. jur. Arif Riza dhe tre mësues asistentë. Njëri prej tyre bëri përkthimin në anglisht. Shkëmbimi ishte i drejtpërdrejtë, i ndershëm dhe miqësor me mirëkuptimin e përbashkët për qëllimin dhe vullnetin e mirë për të vënë në dukje aspektet pozitive dhe negative të programit akademik.

Materiali mbështetës në takim ishte përshkrimi i programit akademik E drejta ndërkombëtare dhe Integrimi ndërkombëtar, i përfshirë në RVV, dhe u diskutua rreth: qëllimeve të programit, metodologjisë së mësimdhënies, praktikës së studentëve, mundësisë për tezat e doktoratës, zhvillimit të metodologjisë dhe hulumtimit, profilit të stafit mësimor dhe përmbajtjes së programit akademik.

Gjatë takimit, ne vumë re se versioni anglisht i RVV-së nuk ishte një përkthim i plotë dhe i saktë i versionit shqip, gjë që krijoi në disa raste, vështirësi në kuptimin e përmbajtjes dhe organizimit të programit akademik. Për këtë arsye dhe bazuar në takimin dhe në vizitën në Universitetin e Prizrenit, vlerësimet dhe rekomandimet në lidhje me programin e studimit janë bazuar në analizën e dokumenteve të transmetuara nga agjencia AKA.

4.2.2. Menaxhimi i studentëve

Menaxhimi i studentëve duket i drejtë, sa i takon kushteve të regjistrimit të studentëve në LL.M.: kërkesa për përfundimin e Juridikut (4 vjet dhe 240 ECTS) dhe standardi i pranimit bazuar në vlerësimin e gjuhës angleze dhe në një provim të përzgjedhur të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane.

Për krahasim, numri i vogël i studentëve të pranuar (25-35) krijon mundësinë e një trajnimi intensiv, si dhe asistencën e ngushtë të studentëve nga ana e mësuesve.

Në këtë mënyrë, studentët kanë një rol të rëndësishëm për shkak të numrit të vogël dhe mentorëve të tyre. Ata nuk do të trajnohen vetëm në mësim teorik dhe praktik, por gjithashtu në përgatitjen për mundësitë e karrierës.

Rekomandime:

- ✓ Duhet marrë masa për sistemin e mbikëqyrjes: çdo student duhet të ketë një mentor/udhëheqës nga pranimi në master deri në fund. Mentori duhet të mbështesë, të motivojë dhe të ndihmojë studentin gjatë karrierës së tij. Mentori duhet të ketë nën mbikëqyrje dy studentë dhe shpeshësia e asistencës së tij duhet të jetë një herë në javë (për shembull 1 orë/student).

4.2.3. Metodologjia e mësimdhënies – punët praktike

Sa i takon metodologjinë e mësimdhënies, RVV dhe takimet nuk patën të dhëna të kënaqshme lidhur me metodat dhe mjetet didaktike dhe pedagogjike që do të përdoren. Në mënyrë evazive, u përmend mundësia e klasave të masterit, por asgjë konkrete.

RVV tregon megjithatë, rëndësinë mes pjesëve teorike dhe pjesëve praktike të programit. Çdo lëndë e masterit do të ketë një sërë praktikash që studenti duhet të përfundojë. Megjithatë, nuk tregohet se çfarë lloj praktikash do të bëjnë studentët, me përjashtim të vizitës së ambasadave të huaja dhe organizata ndërkombëtare në Kosovë¹

Pavarësisht se në RVV janë përmendur disa praktika me institucione të ndryshme si Ministria e Çështjeve të Jashtme dhe Ministria e Integritit Europian², nuk ka asnjë udhëzim rreth përbajtjes, organizimit dhe vlerësimit të praktikave.

¹ RVV, n° 2.8, fq. 401.

² RVV, n° 2.10, fq. 401.

Gjatë takimit, u përmend mundësia e praktikave jashtë Kosovës, por nuk pati asnjë përgjigje rreth mjete të mundshme për realizimin e tyre (për shembull garantët). Ndoshta nuk ka asnjë mjet.

Nga ana tjetër, lidhur me “Temën e Diplomës” është menduar që çdo student duhet të ketë një punë individuale dhe domethënëse rreth çështjes që është zgjedhur nën mbikëqyrjen e mësuesit. Kjo pjesë e masterit është shumë e rëndësishme dhe ata nuk e dinë se sa e rëndësishme është kjo në vlerësimin global të studentit.

Nuk ka asnjë qartësim rreth orëve javore të mbikëqyrjes.

Rekomandime:

- ✓ Të hartohet një “Udhëzues mësuesor” për çdo lëndë, duke treguar qartë pikat e mëposhtme:
 - Të dhënat e kursit
 - Përmbledhjen e kursit
 - Rezultatet mësimore të pritura
 - Përshkrimin e përmbajtjes (në mënyrë të saktë)
 - Ngarkesën mësimore (aktivitetet në klasë dhe jashtë saj)
 - Metodologjinë mësimore
 - Treguesit rreth vlerësimit (procesi i vlerësimit)
 - **Referencat bibliografike TË FUNDIT (ato bazë dhe shtesë) dhe minimumi TRE referenca në ANGLISHT**
- ✓ Në çdo “udhëzues mësuesor”, duhet të tregohet në mënyrë precize përmbajtja e pjesës praktike të studimeve me elementët e përmendur më sipër.
- ✓ Për të zgjeruara ofrimin e praktikave në Institucione dhe në Organizatat private të Kosovës përmes marrëveshjeve që përfshijnë tipin e praktikës, numrin e orëve, vlerësimin e studentëve dhe mbikëqyrjen nga një person i institucionit partner.
- ✓ Përmes universitetin, bëni përpjekje për të gjetur disa burime në mënyrë që të ofrohen grante për studentët më të mirë dhe t’i mundësohet atyre praktika jashtë Kosovës.
- ✓ Në këtë mënyrë, mund të krijohen marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare (BE, Këshilli i Europës etj.) përmes Ministrisë së Çështjeve të Jashtme.

- ✓ Sugjeroni dy orë në javë për mbikëqyrjen e studentëve ³.

4.2.4. Përmbajtja e LLM

In terma të përgjithshëm, të gjitha lëndët korrespondojnë me këtë tip të masterit. Megjithatë nga RVV-ja dhe nga takimi me Dekanin dhe asistentët, u vunë re një sërë mangësish (gabime në përkthim, bibliografia ekskluzivisht në gjuhën shqipe dhe e vjetër).

Rekomandime të përgjithshme:

- ✓ Ju lutem shihni rekomandimet në pikën 4.2.3.
- ✓ Paraqisni programin e detajuar për çdo lëndë

Rekomandime të veçanta:

- ✓ 1.2. *E drejta europiane II: hiqni diferencën me pjesën e parë dhe me temën e parë*
- ✓ 1.5. *E drejta private ndërkombëtare: nuk ka referencë të së Drejtës së Bashkimit European*
- ✓ 1.6. *Çështjet aktuale të IPL: nuk ka referencë për situatën aktuale dhe të shkruar në Ballkan*
- ✓ 1.6.3. *E drejta mjedisore: ri-formuloni përmbajtjen. Nuk ka referencë të së Drejtës së BE-së!*
- ✓ *Organizata Ndërkombëtare II: Eliminoni dhe shpërndani organizatat mes lëndëve të ndryshme*
- ✓ *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut: Ri-formuloni përmbajtjen. Nuk ka referencë rreth sistemeve si OKB, OSBE, Këshilli i Europës dhe Bashkimi European.*
- ✓ *E drejta ekonomike ndërkombëtare: nuk ka referencë të së Drejtës së BE-së.*
- ✓ *Zgjidhje ndërkombëtare Eliminoni dhe shpërndani përmbajtjen mes lëndëve të ndryshme*
- ✓ *Gjykatat Ndërkombëtare: Eliminoni dhe shpërndani përmbajtjen mes lëndëve të ndryshme*
- ✓ 2.5.3. *Kushtet. krahasimtare.: Ri-formuloni përmbajtjen. Specifikoni krahasimet.*
- ✓ Sugjeroni një lëndë të së Drejtës Ndërkombëtare në ANGLISHT.
- ✓ Sugjeroni një lëndë të së Drejtës Evropiane në ANGLISHT

4.2.5. Hulumtimi dhe Bashkëpunimi ndërkombëtar

³ Mund të jetë i njëjti person që është tranjuesi. Sipas lëndës së zgjedhur nga studenti.

Për sa i takon hulumtimit, takimi dhe dokumentet e marra nuk na tregojnë një plan për hulumtimin, pavarësisht se Universiteti i Prizrenit tregon disa herë në RVV rëndësinë e hulumtimit dhe krijimin e një grupi hulumtues.

Lidhur me botimet mësimore, informacioni i marrë është i pa paraqitshëm nga një profil i mirëfilltë shkencor për çdokënd (U komunikuan vetëm 4 CV nga 10 mësuesit e përfshirë në program).

Siç referon bashkëpunimi ndërkombëtar, nuk ka asnjë bashkëpunim efektiv mes Universitetit të Prizrenit, Shkollës së Juridikut dhe një Universiteti Evropian, në të cilën LLM është abonuar.

Rekomandime:

- ✓ Të hartohet – me ndihëm e ekspertëve të jashtëm – një plan hulumtimi për LLM me dy degë: E drejtë Ndërkombëtare dhe E drejta e Bashkimit Evropian. Ky plan duhet të tregojë linjat, synimet, implementimet e pritshme të hulumtimit, burimet njerëzore dhe materiale, planifikimin etj..
- ✓ Ky plan hulumtimi duhet të përfshijë një doktor në ekip për çdo degë (E drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane)
- ✓ Të krijohen lidhje me qendra të tjera të hulumtimit në UPZ, por edhe me Universitete të tjera në Kosovë dhe në Bashkimin Evropian gjithashtu, në mënyrë që temat e hulumtimit të trajtohen thellësisht.
- ✓ Politika për financimin e projekteve të hulumtimit do të zhvillohet me menaxhmentin e lartë dhe rektorin e universitetit
- ✓ Grumbulloni çdo botim dhe aktivitetet e stafit akademik të masterit shkencor. Inkurajoni pjesëmarrjen akademik shkencore në botime dhe në aktivitete ndërkombëtare.
- ✓ Krijoni një përmbledhje elektronike ndërkombëtare (në anglisht) dhe kombëtare.

4.2.6. Stafi

Pas vizitës në terren, u kërkuan CV-të e ekipit të kursit dhe u dorëzuan vetëm 4 – njëra në shqip! Kjo e bën të vështirë gjykimin e përvojës së tyre pas diplomimit dhe statusin e tyre ekzakt në Universitetin e Prizrenit. CV-të për të gjithë stafin mësimor të propozuar duhet të jenë në dispozicion!

Nga ana tjetër, ka një konfuzion lidhur me numrin e mësuesve me kohë të plotë (kontradikta në RVV dhe gjatë takimit) dhe të Statutit të mësuesve (me kohë të plotë-me kohë të pjesshme).

4 CV-të e marra tregojnë nevojën për riformimin e nivelit dhe numrit të botimeve shkencore, njësoj si trajnimet e gjuhës angleze dhe një gjuhë tjetër të Bashkimit Evropian.

Çështja gjinore u ngrit pasi në ekipin mësimor nuk ekziston asnjë grua dhe në ndërkohë jepet lënda e Të drejtave të njeriut!!

Rekomandime:

- ✓ Hartoni një listë të qartë dhe të vërtetë të mësuesve të çdo lënde duke përfshirë Statutin (KPI-KPj), profilin profesional dhe akademik dhe listën e botimeve.
- ✓ Riformoni kriteret e përzgjedhjes së ekipit mësimor: botime, përvoja në mjedisin doktoral, njohuri të anglishtes.
- ✓ Filloni një botim kolektiv aktiv politik.
- ✓ Filloni një përfshirje aktive të grave në master si mësuese, hulumtuese dhe studente.

4.2.7. Infrastruktura/Hapësira/Pajisjet

Vizita në mjediset e universitetit tregoi se klasat janë të mirë-pajisura për aktivitete teorike, por biblioteka është tepër modeste për të qenë një vend i përshtatshëm për hulumtim dhe aktivitete studimore.

Rekomandime

- ✓ Siguroni përmbledhje, si dhe libra të së drejtës ndërkombëtare dhe evropiane.
- ✓ Siguroni një databazë elektronike dhe qasje në burimet ligjore ndërkombëtare dhe evropiane.
- ✓ Lidhni bibliotekat e Kosovës me njëra-tjetrën (krijoni një rrjet).
- ✓ Jini në kontakt me qendrat e huaja të dokumenteve ndërkombëtare dhe evropiane në mënyrë që të arrini një përmbledhje të dokumentuar të cilësisë në anglisht..

4.2.8. Komente nga Universiteti i Prizrenit

Të gjitha rekomandimet janë implementuar në programin e studimit që është i lidhur me

raportin. Ndryshimet janë bërë në bazë të rekomandimeve dhe të gjithë rekomandimet janë theksuar.

4.2.9 Përfundime

- ✓ Bazuar në këtë informim, rekomandohet akreditimi për tre vite, por me kërkesën “sine qua non” të aspekteve të mëposhtme:
- ✓ Organizimin dhe mbikëqyrjen e LLM nën përgjegjësinë e përbashkët të mësuesit me kohë të plotë (pjesa ndërkombëtare) të Universitetit të Prizrenit dhe disa akademikëve nga ndonjë Universitet Europian (pjesë e së drejtës europiane). Ky person do të mbikëqyrë konfigurimin përfundimtar të LLM, kontraktimin e stafit me kohë të pjesshme, koordinimin mes mësuesve, përpunimin e planit të hulumtimit dhe krijimin e një marrëveshjeje konkrete dhe formale me institucionet dhe universitetet europiane dhe të huaja.
- ✓ Trajnime intensive në anglisht për mësuesit aktualë.
- ✓ Rifreskimi i punimeve dhe furnizimit të bibliotekës (kompjuterë, libra, përmbledhje)
- ✓ Reformulimi i përmbajtjes dhe paraqitjes të kurseve LLM.

4.3. Menaxhment në Agrobiznes [Bujqësi] (Msc) (Prof. Dr. Jochen Kantelhardt)

4.3.1. Programi akademik dhe menaxhimi i studentëve

Programi i studimit “Menaxhim në Agrobiznes – MSc” përputhet mirë me parimin udhëheqës të institucionit; në veçanti, është për t’u theksuar se ai kontribuon në arsimin e studentëve në një fushë, që është e rëndësishme së përgjithshme për Kosovën, dhe rëndësinë e veçantë për rajonin e Prizrenit. Është vënë re pozitivisht se plani i studimeve shfaq shqetësime mjedisore, të shprehura në lëndën “Ekonomia e mjedisit dhe burimeve natyrore”.

Programi i studimit “Menaxhim në Agrobiznes – MSc” është bazuar në dy programe masteri gjermane, konkretisht “Agro-ekonomi” dhe “Agrobiznes: (të Universitetit të Hohenheim-it) dhe programin master sloven “Agro-ekonomi” (Universiteti i Maribor-it). Programi i studimit zgjedh në mënyrë të arsyeshme kurset që janë me rëndësi për Kosovën dhe rajonin e Prizrenit dhe që korrespondojnë në të njëjtën kohë me silabuset e standardeve ndërkombëtare.

Në lidhje me pranimin e studentëve, duhet thënë se një ekzekutim i suksesshëm dhe eficient i programit të studimit kërkon që studentët të kenë njohuri paraprake në bujqësi dhe në menaxhimin e fermës. Megjithatë, nuk ka mundësi (të paktën nuk ka mekanizëm të përshkruar) për të përjashtuar studentët nga pjesëmarrja në program apo për t’i detyruar ata të marrin pjesë në kurse shtesë. Megjithatë, rekomandohet fort krijimi i një mekanizmi të tillë (dhe krijimi dhe përshkrimi i tij në programin e studimit).

Sa i takon kurseve të detyrueshme, mungon një kurs në menaxhimin total të cilësisë dhe rekomandoj shtimin e një kursi të tillë. Në lidhje me kurset me zgjedhje, duhet theksuar se ofrohet vetëm një numër i vogël kursesh. Duhet këshilluar fuqimisht rritja e numrit të kurseve me zgjedhje duke i dhënë studentëve mundësinë për të marrë pjesë në kurset e ofruara në programin Master “Kontabilitet”; një mundësi e tillë do të rriste gjithashtu mundësinë e studentëve për të formësuar profilin e tyre të studimit.

Duhet vënë në dukje negativisht, se leksionet informojnë programin studimor vetëm në një mënyrë të përgjithshme mbi metodat e tyre të mësimdhënies dhe mësimnxënies; në përgjithësi, ato japin të njëjtin informacion standard: “Leksionet, ushtrimet, seminarët, konsultimet, puna në grup, testet”. Rrjedhimisht, nuk është e qartë nëse trajnimi i studentëve bazohet realisht mbi një gamë kaq të gjerë të metodave didaktike. Është qartësisht e këshillueshme që mësuesit të përpunojnë më mirë dhe individualisht konceptet e tyre didaktike lidhur me nevojat e kursit të tyre. Një aspekt pozitiv i programit të studimit është bashkëpunimi i ngushtë me biznesin lokal. Kjo ka rëndësi të lartë në mënyrë që të ofrohen praktika dhe të parashihen mundësi punësimi për studentët. Në Kosovë dhe në rajonin e Prizrenit, kjo është me rëndësi të jashtëzakonshme për shkak të situatës së vështirë të tregut të punës.

4.3.2. Stafi

Numri i stafit të përhershëm dhe i mësuesve të angazhuar shtesë nga jashtë fakultetit, si dhe raporti i të dyve, duket i përshtatshëm për programin e studimit dhe parimisht lejon mbikëqyrje të mirë të tezës së studentëve. Për më tepër, theksohet pozitivisht se shumica e stafit mësimor është me kohë të plotë, e brendshme dhe e përhershme. Megjithatë, duket se nuk ka profesorë të rregullt të angazhuar në programin e studimit, siç sugjerohet nga udhëzimet e AKA-së. Kualifikimi dhe aftësia e stafit akademik në lidhje me nivelin akademik dhe didaktik të universitetit duket e përshtatshme. Kjo theksohet nga diskutimi me studentët: Studentët shprehën (në përgjithësi) kënaqësinë e tyre të qartë (një gjykim i tillë ishte i mundur ngaqë shumica e mësuesve japin leksione edhe në programe të tjera studimi)/ Megjithatë, gjykimi i mësuesve është i ndërlikuar dhe bazuar në materialin e dhënë, i mundshëm vetëm në një mënyrë të kufizuar.

4.3.3. Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Vizita në terren në përgjithësi tregoi se hulumtimi (ndërkombëtar) në fushën e agrobiznesit nuk është shumë i fortë në Universitetin e Prizrenit. Për më tepër, personat përgjegjës për programet e studimit nuk paraqesin strategji ndërkombëtare bashkëpunimi. Në lidhje me përfshirjen e studentëve në aktivitetet e hulumtimit, duhet theksuar se është e paqartë në diskutime se si dhe në çmasë studentët janë të informuar mbi dhe të integruar në aktivitetet e hulumtimit (ndërkombëtar). Ndonëse mund të supozohet se parakushtet për integrimin e hulumtimit në programet studimore nuk janë premtuese, duhet vënë në dukje se nuk u realizua një analizë e duhur për masën në të cilën aktivitetet e hulumtimit japin efekte në mësimdhënie dhe trajnim (për shkak të situatës së planifikimit të programit të studimit). Megjithatë, rekomandohet zgjerimi i aktiviteteve (ndërkombëtare) të hulumtimit dhe në lidhje me programin e studimit në vlerësim këshillohet përfshirja e studentëve në aktivitetet e hulumtimit (p.sh. brenda zonës së tezës së Masterit).

4.3.4. Financa dhe Infrastruktura/ Hapësira dhe Pajisjet

Pajisjet mësimore dhe infrastruktura e përshtatshme janë kërkesat bazë për studime akademike të suksesshme: fakulteti ofron salla mjaftueshëm të mëdha leksionesh dhe dhoma seminaresh, që janë të pajisura me infrastrukturën teknike bazë (sidomos projektorët), si dhe me tabela. Shqetësimi kryesor është biblioteka. Veçanërisht qasja në literaturën teknike të fundit është e pamjaftueshme: inventari është i vogël dhe vetëm pak libra dhe tekste teknike janë në dispozicion. Revistat shkencore nuk janë (me të drejtë) të pranishme dhe qasja via internet në abonimin e universitetit nuk u konfirmua.

4.3.5. Menaxhimi i cilësisë

Ky program studimi nuk planifikon krijimin e një programi specifik për menaxhimin e cilësisë, por ka në plan përdorimin e programit të rregullt të universitetit. Megjithatë, duke qenë se ky program studimi është në fazën fillestare, rekomandohet të përdoret intensivisht sistemi i vlerësimit, për të kontrolluar aplikimin e tij të rregullt dhe për të shfrytëzuar analizën respektive statistikore.

4.3.6. Komente nga Universiteti i Prizrenit

1. Testi i pranimit do të shërbej, krahas APG, për studentët që aplikojnë nga zona të tjera. Testi do të ketë lidhje me lëndët bazë. Përmes testit hyrës ne do të përzgjedhim studentët që demonstrojnë njohuri në këtë fushë. Bazuar në rekomandimin, ne kemi shtuar kurset e detyrueshme në “Menaxhimin e cilësisë” dhe një kurs me zgjedhje për çdo semestër. Përveç kësaj, studentët do të kenë të mundur të ndjekin kurse në programin e Kontabilitetit që është në UPZ (për tekstet e shtuara, shih kurrikulën).
2. Profesorët do të informojnë kërkesat e ACA-së për të aplikuar metodologjinë e mësimdhënies, si interaktive, gjë që do të përfshijë objektiva të qartë dhe ushtrime për aplikim.
3. Gjatë këtij viti në UPZ ka një PhD në fushën e agrobiznesit si profesoreshë Dita Krasniqi që me gjasë do të angazhohet në këtë program. Që nga ky vit akademik do të jetë një profesoreshë e rregullt në UPZ dhe do të jetë në gjendje të angazhohet në program.
4. UPZ ka arritur bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës, që shprehu vullnetin për të bashkëpunuar me UPZ në shkëmbimin e studentëve dhe profesorëve nga kjo fushë (për më tepër kontrolloni link-un <http://uni-prizren.com/sq/ngjarje / 538>). UPZ gjithashtu ka bashkëpunim me Universitetin bujqësor të Tiranës, Shqipëri, me të cilin ne do të bashkëpunojmë, veçanërisht në kontekstin e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Përveç kësaj, me Fakultetin e Bujqësisë, Departamentin e Agrobiznesit Korçë, Shqipëri. Për më tepër, ne synojmë bashkëpunimin me Universitetin e Maribor-it dhe Universitetin e Hohenheim-it, që bazohen në skicimin e këtyre kurrikulave, ku ne synojmë të shkëmbejmë profesorë dhe studentë.
5. Studentët do të kenë mundësinë të përdorin fonde nga Biblioteka e UPZ, e cila pas akreditimit të programit do të pasurohet me literaturë relevante në këtë fushë. Përveç kësaj, studentët mund të përdorin bibliotekat elektronike.
6. UPZ në fund të çdo semestri aplikon sistemin vlerësues për profesorë.....

7. Ne kemi bashkëpunim të ngushtë me Universitetin Bujqësor në Tiranë dhe në Prishtinë. Respektivisht Universiteti Bujqësor dhe Veterinarisë. Nga Universiteti Ekonomik dhe Bujqësor në Tiranë, Shqipëri, ne do të angazhojmë Prof. As. Dr. Ilir Kapaj.

4.3.7. Rekomandime (Përfundime)

Në lidhje me Menaxhimin në Agrobiznes (MSc) vendosa se jam i kënaqur me përgjigjet dhe se i pranoj ato dhe se rekomandoj akreditimin e programit të studimit për tre vite.

Në veçanti, vlerësoj integrimin e dy ass. Profesorëve të rinj, Z. Ilir Kapaj dhe Znj. Drita A. Krasniqi; punësimi i tyre qartazi pasuron programin e studimit dhe rrit numrin e stafit me njohuri të gjuhës angleze dhe ka një vlerë pozitive nga pikëpamja e çështjeve gjinore.

Për më tepër, vlerësoj përpjekjen për përgjegjësit e programit të studimit që parashikojnë kontakte ndërkombëtare dhe shpresoj që menaxherët e programit të studimit të jenë të suksesshëm në krijimin e një rrjeti shkëmbimi me mësues nga Universiteti i Hohenheim-it.

Më tej, vlerësoj pozitivisht përshtatjen e silabusit dhe integrimin e kurseve të reja. Megjithatë, dua të theksoj sërish se ka shumë rëndësi për mua krijimi i një plani zhvillimi, që demonstroi në veçanti se si mund të realizohet me sukses integrimi i profesorëve të rregullt në program brenda tre viteve të ardhshme.

5. Konkluzione përfundimtare nga EE-ja

EE rekomandon një ri-akreditim dhe akreditim 3 VJEÇAR të:

- ✓ **Administrim Biznesi (BA) dhe Menaxhment Ndërkombëtar (BA)**
- ✓ **Menaxhment në Agrobiznes (MA)**
- ✓ **E drejta ndërkombëtare dhe Integrimi Evropian (MA)**

Prof. Dr. Hans Tümmers

Prof. Dr. Frédéric Mertens de Wilmars

Prof. Dr. Jochen Kantelhardt

Raporti final , 22 qershor 2015